



REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVA - PREDSIEDNIK

27 mars 2012

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Neni 4 (3), Neni 83 dhe Neni 84 (1), (2) dhe (4), Presidentja e Republikës së Kosovës më datën 27 mars 2012 miratoi

RREGULLAT E PROCEDURËS PËR KËSHILLIN KOMBËTAR PËR INTEGRIM EVROPIAN

1. Dispozitat e përgjithshme

Rregullat e Procedurës për Këshillin Kombëtar për Integrim Evropian (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) përcaktojnë qëllimin, funksionet, përbërjen dhe mënyrën e punës së Këshillit.

2. Qëllimi

Këshilli Kombëtar për Integrim Evropian është mekanizëm bashkërendues institucional nën udhëheqjen e Presidentes së Republikës së Kosovës. Në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, Këshilli bashkërendon ndërtimin e konsensusit institucional dhe shoqëror dhe rekomandon konkretizimin e veprimeve në procesin e integrimit evropian.

3. Funksionet e Këshillit

Këshilli ka këto funksione:

- Të përcaktojë orientimin strategjik të procesit të integritit evropian të Republikës së Kosovës;
- Të koordinojë dhe harmonizojë qëndrimet e institucioneve, partive politike dhe shoqërisë civile në procesin e integritit evropian, me qëllim që të sigurojë përkrahjen e nevojshme institucionale politike dhe shoqërore për zbatimin e reformave të nevojshme;
- Të përcjellë progresin e Republikës së Kosovës drejt integritit në Bashkimin Evropian.
- Të japë rekomandime për procesin e integritit evropian të Republikës së Kosovës, përfshirë edhe për negociatat me Komisionin Evropian dhe me shtetet anëtare të BE-së.

4. Përbërja e Këshillit

4.1 Këshilli ka këtë përbërje:

4.1.1 Udhëheqëse – Presidentja e Republikës së Kosovës;

4.1.2 Anëtarë të Këshillit janë:

- Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Kryeministri i Republikës së Kosovës;
- Kryetari i Komisionit Parlamentar për Integrim Evropian;
- Kryetari i Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme;
- Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit e partive dhe subjekteve politike parlamentare / shefat e grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës;
- Ministri i Punëve të Jashtme;
- Ministrja e Integritit Evropian;
- Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Kryetari i Akademisë së Shkencës dhe Arteve të Kosovës;
- Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës;
- Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës;
- Përfaqësues nga shoqëria civile.

4.2 Anëtarët e Këshillit marrin pjesë në takime dhe kontribuojnë në punën dhe diskutimet e Këshillit.

4.3 Bazuar në agjendën e mbledhjes, Udhëheqësja mund të ftojë përfaqësues të institucioneve tjera të marrin pjesë në mbledhjet e caktuara të Këshillit.

5. Takimet e Këshillit

5.1 Takimet e Këshillit do të mbahen së paku dy herë në vit.

5.2 Takimet e Këshillit thirren nga Udhëheqësja e Këshillit.

5.3 Anëtarët e Këshillit mund t'i propozojnë Udhëheqëses së Këshillit mbledhjen e Këshillit jo më pak se 7 ditë pune para mbajtjes së takimit.

6. Përgatitja e takimeve

6.1 Presidentja thërret takimin, jo më vonë se 10 ditë pune para mbajtjes së takimit.

6.2 Anëtarët e Këshillit i propozojnë Udhëheqëses pika të veçanta të rendit të ditës, jo më vonë se 7 ditë pune para mbajtjes së takimit.

6.3 Udhëheqësja mund të thërrasë takime edhe në afat më të shkurtër, sipas nevojës.

6.4 Të gjitha materialet për takimet e Këshillit do të përgatiten dhe shpërndahen nga Sekretariati.

7. Mbajtja e takimeve dhe përfundimet

7.1 Takimet e Këshillit drejtohen nga Udhëheqësja. Udhëheqësja kujdeset për rendin e folësve, kohëzgjatjen e fjalës dhe mbarëvajtjen e diskutimeve.

7.2 Sekretariati mban procesverbalet e takimit dhe materialet tjera të takimeve.

7.3 Të gjitha procesverbalet dhe materialet tjera të takimeve dhe punës së Këshillit ruhen nga Sekretariati.

8. Rekomandimet e Këshillit

8.1 Udhëheqësja e Këshillit lëshon rekomandime për hapat e më tutjeshëm pas çdo takimi të Këshillit, bazuar në diskutimet e bëra.

8.2 Rekomandimet e Këshillit janë dokumente publike.

9. Sekretariati

9.1 Sekretariati i Këshillit do të veprojë në kuadër të Zyrës së Presidentes së Republikës së Kosovës. Në këtë detyrë, Sekretariati do të ndihmohet nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Integritimit Evropian.

9.2 Sekretariati do të kryejë këto detyra:

- Të përgatisë dhe të shpërndajë rendin e ditës së takimeve, sipas udhëzimeve të Udhëheqëses;
- Të organizojë takimet;
- Të sigurojë ndihmë teknike gjatë takimeve;
- Të përgatisë procesverbalet e takimeve;
- T'u shpërndajë të gjithë pjesëmarrëseve materialet e takimeve;
- Të mbajë arkivin e materialeve të takimeve;
- Të ndërmarrë dhe të koordinojë detyra tjera të cilat i ngarkohen nga Udhëheqësja.

10. Dispozitat përfundimtare

Këto rregulla të procedurës hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Udhëheqësja e Këshillit
Kombëtar për Integritim Evropian

Atifete Jahjaga
Presidente e Republikës së Kosovës

